

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
" METAL FORM PRO "

Më datë **01.11.2023**, mbështetur në ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, dhe akte të tjera ligjore e nënligjore, në cilësinë e Ortakëve themelues:

1. **Z. Xhulio Lavdari**, shtetas shqiptar, lindur më **21.05.1994** në Berat dhe banues në lagjen "Uznovë", Rruga "13 Shtatori", Berat, madhor me zotësi të plote juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit ID me Nr. 038252046 dhe Nr. personal J40521069R.
2. **Z. Marsel Agolli**, shtetas shqiptar, lindur me **03.02.1986** në Vashtemi Korçë dhe banues në lagjen "Astir", Rruga "Loni Ligori", Tiranë, madhor me zotësi të plote juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit ID me Nr. 034294937 dhe Nr. personal I60203032D.

Deklarojnë se kanë vendosur të nënshkruajnë këtë kontratë themelimi për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (me poshtë referuar si Shoqëria), me termat e mëposhtëm:

Neni 1
Emërtimi

Shoqëria emërtohet "**METAL FORM PRO**" SH.P.K. Emërtimi i shoqërisë mund të shkruhet me shkronja të mëdha ose të vogla.

Neni 2
Selia

Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet në Tiranë, Katund i Ri, Rruga "Arkitekt Sinani", Godina nr.40/1, Zona Kadastrale 2119, me nr. Pasurie 223/117, kodi postar 1050.

Neni 3
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit Tiranë. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4 **Objekti i veprimtarisë**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

Përpunim të fletëve metalike dhe profileve metalike, konstruksione metalike, saldime, lyerje, montime, produkte të krijuara me këto materiale metali në kombinim dhe me materiale të tjera të ndryshme, prodhim dhe tregtim me shumicë e pakicë, import-eksport të tyre.

Projektim - programim për makineritë me kontroll numerik CNC (si Lazer, Frezë, Torno, Pjegatриçe etj.) si dhe përpunimin e metaleve me këto makineri. Ndërtimin në fushën e objekteve industriale, civile dhe publike.

Shoqëria mundet të realizoj çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 5 **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 600,000 (Gjashtëqindë mijë) lekë. Kapitali themeltar është i përbërë nga 2 (dy) kuota kapitali i ndarë në:

- **Z. Xhulio Lavdari 1(një) kuotë me vlerë të përgjithshme 300,000 (treqindmijë) lekë.**
- **Z. Marsel Agolli 1(një) kuotë me vlerë të përgjithshme 300,000 (treqindmijë) lekë.**

Neni 6 **Kontributet e Kapitalit themeltar**

Derdhja e kapitalit themeltar është bërë në masën dhe mënyrën e mëposhtëme:

- **Z. Xhulio Lavdari ka kontribuar në para në shumën 300,000 (treqindmijë) lekë.**
- **Z. Marsel Agolli ka kontribuar në para në shumën 300,000 (treqindmijë) lekë.**

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin themeltar të shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre si më poshtë:

- **Z. Xhulio Lavdari është zotërues i 1(një) kuotë kapitali me vlerë të përgjithshme 300,000 (treqindmijë) lekë ose 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.**
- **Z. Marsel Agolli është zotëruese e 1(një) kuotë kapitali me vlerë të përgjithshme 300,000 (treqindmijë) lekë ose 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.**

Neni 7 **Kuotat dhe kalimi i kuotave të kapitalit**

Zotërimi i kuotave, mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave, pjesëtimi dhe transferimi i tyre do të bëhen sipas procedurave të parashikuara në ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe nga statuti i shoqërisë.

Neni 8 Administrimi

Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator persona fizike, qofshin këta edhe jo ortak të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori/ët qendrojnë në postin e tyre për pesë vjet financiarë, me mundësinë për tu rizgjedhur. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në të gjitha rrethanat që kanë lidhje me objektin e shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo statuti i jep Asamblesë duke përfshirë delegimin e kompetencave edhe personave të tjerë me prokurë të posaçme. **Administratori i parë i shoqërisë është Z. Xhulio Lavdari, shtetas shqiptar, lindur më 21.05.1994 në Berat dhe banues në lagjen “Uznove”, Rruga “13 Shtatori”, Berat, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit ID me Nr. 038252046 dhe Nr. personal J40521069R.**

Ai do të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB). Të gjitha shpenzimet që do të kryen deri në regjistrimin e shoqërisë si person juridik do të përfshihen në bilancin e shoqërisë.

Neni 9 Të tjera

Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Kushtet e punës, shpërblimet, oraret, pushimet dhe sigurimet shoqërore të personelit do të rregullohen nga kontrata kolektive ose ajo individuale e punës, si dhe nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

Neni 10 Kundërshtimet

Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj midis ortakëve ose një ose më shumë ortakëve dhe shoqërisë do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë midis të interesuarëve për ti zgjidhur miqësisht. Në rast të kundërt i nënshtrohen juridiksionit të Gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.


Neni 11

Ky Akt Themelimi është përgatitur në katër kopje të barazvlerëshme në gjuhën shqipe.

ORTAKËT E SHOQËRISË “METAL FORM PRO” SH.P.K.

XHULIO LAVDARI

MARSEL AGOLLI

Marsel Agolli


Xhulio Lavdari
